

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shehaj në takimin ndërparlamentar me BE-në: Rama po zhvillon një sulm të paprecedentë ndaj drejtësisë
ADRESA	https://albeu.com/lajme/shehaj-ne-takimin-nderparlamentar-me-be-ne-rama-po-zhvillon-nje-sulm-te-paprecedente-ndaj-drejtësisë/1031336/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 16:44:34 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 16:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	24038410cb72d281347aa14212c6fcdc9ac9adaf6b0eadbc0dd4443400547da9
TEKSTI	bb6b6d66c2cf0d1cce6963b4643917ea073a937a04fa30717b2e6ac9840e0581
PAMJA	7e28834d6973917c03b14af40eee1cf40735a1e6403f5ebe9e5b4a43a7d48020

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4cd0ec36dd4496a11c8c63fe2257791fe033748baa0ab179c947771ea14ccd6d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4cd0ec36dd4496a11c8c63fe2257791fe033748baa0ab179c947771ea14ccd6d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Shehaj në takimin ndërparlamentar me BE-në: Rama po zhvillon një sulm të paprecedentë ndaj drejtësisë



Kreu i Partisë Mundësia, Agron Shehaj, e vuri në qendër të fjalës së tij në Konferencën Ndërparlamentare me Bashkimin Europian shqetësimin për presionin e madh ndaj drejtësisë shqiptare. Sipas tij, kjo situatë po vë në rrezik një prej investimeve më të rëndësishme të realizuara në Shqipëri nga BE-ja, me mbështetjen e SHBA-së.

Shehaj deklaroi se shqiptarët e shohin anëtarësimin në Bashkimin Europian si një mundësi për të fituar më në fund të drejtat që u takojnë dhe nënvizoi se procesi i integritetit duhet të vijojë pa u ndërprerë.

"Shqiptarët e duan Bashkimin Europian, sigurisht. Jo vetëm sepse e konsiderojnë Shqipërinë pjesë të Europës, por sepse tek BE-ja shohin shpresën. Ata besojnë se, kur Shqipëria të bëhet pjesë e Bashkimit Europian, më në fund të drejtat e tyre do të njihen. Kjo është ëndrra e madhe e shqiptarëve", u shpreh ai.

Sipas kreut të Mundësisë, sistemi i ri i drejtësisë, i ndërtuar me kontributin e partnerëve ndërkombëtarë, ndodhet sot përballë një kërcënimi serioz.

"Arsyeja pse e konsiderova të rëndësishme të flisja para jush është se po rrezikohet dhe mund të bllokohet një nga investimet më të mëdha të BE-së, të mbështetur edhe nga SHBA-ja. Drejtësia nuk po përballlet thjesht me presion; ndaj saj po zhvillohet një luftë e paprecedentë", deklaroi Shehaj.

Ai akuzoi kryeministrin Edi Rama dhe shumicën qeverisëse se e sulmojnë sistemin e drejtësisë sa herë që përfaqësues të mazhorancës hetohen ose përballen me akuza për korrupsion.

"Në këto konferenca e keni dëgjuar kryeministrin të flasë për drejtësinë, por nuk e keni parë mënyrën se si ai u drejtohet shqiptarëve. Përmes mediave të tij, ai e sulmon drejtësinë çdo ditë. Sa herë që kjo e fundit nxjerr para përgjegjësisë përfaqësues të mazhorancës dhe i akuzon për korrupsion, Edi Rama reagon duke e sulmuar", tha kryetari i Partisë Mundësia.

të fundit /



Zjarri në banesë në Angli i merr jetën nënës dhe tre fëmijëve, fami...



Sylvester Stallone rrëfen betejën me fizikun: "U bëra bulimi...



Rashica, protagonist kryesor i Kosovës në dy sfidat e fundit ndaj...



LDK-ja propozon përfaqësuesit e saj për 16 komisione...



Stresi merr vendimin, largohet nga rrjetet sociale, ja çfarë njoft...



Besian Mustafa mungoi në votimin e deklaratës së Kuvendit për...



A do të pësojë ndryshime ligji për Gjykatën Speciale?



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Shehaj përmendi edhe konfliktin lidhur me pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke e cilësuar atë një tjetër shfaqje të trysnisë ndaj drejtësisë.

"Situata shkoi deri aty sa pagat nuk u paguan. Edi Rama mendon se pagat e një prokurori apo gjyqtari janë të ngjashme me ato të politikanëve të korruptuar që kanë drejtuar vendin gjatë këtyre 35 viteve. Këta të fundit nuk kanë nevojë për paga, pasi ato janë të papërfillshme përballë përfitimeve që marrin nga pushteti. Megjithatë, drejtësia nuk është e përkryer dhe aty ka prokurorë e gjyqtarë që jetojnë me ato paga", u shpreh ai.

Gjatë fjalës, ai foli edhe për protestat që prej më shumë se tre muajsh zhvillohen në Tiranë, si dhe për vështirësitë që, sipas tij, qytetarët shqiptarë përjetojnë në përpjekje për të garantuar të drejtat themelore.

"Duhet ta kuptoni, miq të nderuar të Shqipërisë, se vendi ynë fatkeqësisht është përballë padrejtësive. Ashtu siç unë, si drejtues i një partie opozitare, duhet të luftoj për lirinë e fjalës dhe për të ushtruar opozitën, edhe çdo qytetar shqiptar përballë çdo ditë me betejën për të drejtat themelore, të drejta që ju ndoshta nuk mund t'i imagjinoni", deklaroi Shehaj.

Në përfundim, ai falënderoi përfaqësuesit europianë për mbështetjen e vazhdueshme ndaj rrugës së Shqipërisë drejt integritetit në Bashkimin Europian.

"Ju falënderoj që ndodheni këtu dhe që, pavarësisht problemeve, vazhdoni të besoni se Shqipëria duhet të jetë pjesë e Bashkimit Europian."

Shtuar më 28.09.2026 18:44

Tags: [-Politikë](#), [kryesore](#), [Lajmet e fundit](#), [Shqipëria](#), [Të Gjitha](#)



Stresi merr vendimin, largohet nga rrjetet sociale, ja çfarë njoftoi reperi



Zjarr i përmasave të mëdha në kodrën pranë Mëmëlishtit, flakët kërcënojnë pyllin m...



Dyshohet se abuzoi sek*ualisht me një grua dhe i mori paratë, policia kërkk...



Salianji: PD-ja duhet të mobilizojë qytetarët, Berisha po bëhet penges...



Skandali i Vlora Hysenit, përgjegjësi e Edi Ramës/ Salianji: Janë publikuar s...



Skandalet e Ballukut, AKSHI-t, KAYO-s e SHISH/ Flet ish-Presidenti Bamir...



Bamir Topi për Vlora Hysenin: Kalimi i saj në Shqipëri ndodhi gjatë...



Skandali te SHISH/ Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.